



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 618 / 12 Prot

Durrës, më: 05.03.2026

V E N D I M

Nr. 33, datë 05.03.2026

PËR

"MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ZHVILLIMIN E KURSIT "GJUHË SHQIPE PËR TË HUAJT" NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; të Statutit të UAMD-së; të Rregullores së UAMD-së; bazuar në Vendimin e Senatit akademik nr. , datë 2025 "për miratimin e ofrimit të kursit të gjuhës shqipe nga departamenti i gjuhës shqipe dhe departamenti i letrarisë pranë Fakultetit të Edukimit, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës"; referuar shkresës së Fakultetit të Edukimit me nr. 171/2 prot., datë 27.02.2026 për "Ripërcjellje informacioni mbi ofrimin dhe strukturimin e kursit të gjuhës shqipe për studentët e huaj në UAMD", relacionit të Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave Nr.171/3, datë 27.02.2026, si dhe në relacionin e Drejtorisë Juridike, Nr. 171/4, datë 02.03.2026, në mbledhjen e datës 05.03.2026 Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores për zhvillimin e kursit "Gjuhë shqipe për të huajt" në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratimin e tarifës përkatëse.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ ALEKSANDËR MOISIU” Durrës
FAKULTETI I EDUKIMIT

RREGULLORE PËR ZHVILLIMIN E KURSIT “GJUHË SHQIPE PËR TË HUAJT”

*Miratuar me Vendim Nr. 33 datë 05.3.26 të Senatit Akademik të Universitetit
“ Aleksandër Moisiu ” Durrës*

I. Hyrje

Baza Ligjore

Kjo rregullore mbështetet në ligjin nr. 80/ 20215 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin dhe Rregulloren e UAMD-së , Vendimin e Senatit Akademik, Nr 114, datë 24.10.2025, Rregulloren e FE, në zbatim të Urdhërit të Dekanatit të FE, Nr. 25. datë 02.12.2025., Strategjisë afatshkurtër për procedurën e rekrutimit të studentëve të huaj në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, për vitin akademik 2025-2026, miratuar me Vendim Senati Akademik nr.79, datë 08.07.2025

Kursi “Gjuhë shqipe për të huajt” ofrohet pranë Fakultetit të Edukimit nga Departamenti i Gjuhës shqipe dhe Departamenti i Letërsisë. Ky kurs zhvillohet dhe administrohet nga Fakulteti i Edukimit.

Parime të përgjithshme

Neni 1.

Kursi i gjuhës shqipe për të huajt synon të zhvillojë kompetencat gjuhësore në dëgjim, lexim, të folur dhe të shkruar; të nxisë njohjen e kulturës shqiptare përmes përdorimit të gjuhës në kontekste reale; dhe të përgatisë pjesëmarrësit për përdorim akademik, profesional ose social të gjuhës shqipe.

Mësimi dhe vlerësimi i gjuhës shqipe si gjuhë e huaj realizohen përmes një qasjeje të integruar, e cila harmonizon dimensionin gjuhësor me atë kulturor, si pjesë thelbësore e kompetencës komunikuese. Kompetenca gjuhësore trajtohet në ndërvarësi të ngushtë me kompetencën sociokulturore dhe ndërkulturore, duke reflektuar nevojën që nxënësi jo vetëm të zotërojë strukturat e gjuhës, por edhe t'i përdorë ato në mënyrë të përshtatshme në kontekste reale komunikimi.

Neni 2.

Qëllimi dhe misioni i rregullores “Gjuhë shqipe për të huajt”

Rregullorja ka për qëllim të vendosë kornizat institucionale dhe kriteret operative për organizimin, zhvillimin, vlerësimin dhe certifikimin e kursit “Gjuhë shqipe për të huajt” pranë Fakultetit të Edukimit, duke garantuar një proces të integruar, të standardizuar dhe në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencës për Gjuhët (KPERGj/CEFR). Ajo synon të sigurojë zhvillimin e kompetencave gjuhësore, kulturore dhe ndërkulturore të pjesëmarrësve, si dhe një trajtim të balancuar të aftësive të dëgjimit, të folurit, të leximit dhe të shkrimit.

Misioni i Rregullores

Misioni i rregullores është të krijojë një mjedis mësimor të sigurt, të strukturuar dhe të standardizuar, i cili:

- a. Nxiti përdorimin funksional dhe kuptimplotë të gjuhës shqipe në situata reale komunikat.
- b. Integron dimensionin gjuhësor me atë kulturor dhe sociokulturor për një zhvillim të plotë ndërkulturor;
- c. Siguron një proces të drejtë, transparent dhe objektiv të vlerësimit dhe certifikimit të kompetencës gjuhësore dhe ndërkulturore;
- d. Përgatit pjesëmarrësit për përdorim akademik, profesional dhe social të gjuhës shqipe;
- e. Promovon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së kursit, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira profesionale.

Neni 3.

Strukturimi i niveleve dhe progresioni cilësor

Strukturimi i niveleve gjuhësore nuk mbështetet vetëm në rritjen sasiore të kërkesave (kohëzgjatje e prodhimit gjuhësor, numër fjalësh, vëllim teksti), por mbi të gjitha në dallime cilësore të kompetencave:

- a. gjuhësore (leksikore, gramatikore, fonologjike);
- b. pragmatike (qëllimi komunikativ, aktet e të folurit);
- c. diskursive (koherenca, kohezioni, organizimi i tekstit);
- d. stilistike (përshtatja e regjistrimit dhe tonit).

Neni 4

Lloji i ligjërimit

Lloji i ligjërimit që pritet për secilin nivel përkufizohet si më poshtë:

1. **A1–A2** - ligjërime funksionale, situative dhe personale, të lidhura me nevojat bazë të komunikimit të përditshëm;
2. **B1** - ligjërime narrative dhe shpjeguese, me aftësi për të përshkruar përvoja, ngjarje dhe procese;
3. **B2** - ligjërime argumentuese, reflektuese dhe analitike, me theks në arsyetim, qëndrim kritik dhe strukturim të qartë të mendimit.

Sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencës për Gjuhët (KPERGj) njohuritë në gjuhë ndahen në 3 nivele të mëdha të aftësisë së gjuhës: A, B dhe C - përkatësisht:

- **Përdoruesi bazë** ("*Përdoruesi themelor i gjuhës*", që kupton dhe përdor disa elementë të thjeshtë të gjuhës);
- **Përdoruesi i pavarur** ("*Përdoruesi i pavarur i gjuhës*", në këtë nivel mund të komunikojë "pa shumë fjalor", por mund të shprehë një mendim);

- **Përdorues i aftë** (*"Përdoruesi i aftë"*, në këtë nivel përdoruesi i përafrohet nivelit të folësve vendas të gjuhës; jo vetëm që mund të flasim për çdo temë, por edhe me fjalorin dhe strukturat e duhura gramatikore).

Secili prej këtyre niveleve është i ndarë në dy të tjera, të cilat tregohen me shkronja - A1, A2, B1, B2, C1, C2 – në 6 nivele në total.

Nivelet e aftësive sipas KPERGj -së janë si më poshtë:

A – Niveli fillestar:

A1 - Niveli i kalimit (personi mund të kuptojë dhe përdorë shprehje të njohura, si dhe fjali të thjeshta, të cilat synojnë përmbushjen e nevojave konkrete. Mund të prezantojë veten dhe të tjerët dhe të pyesë të tjerët lidhur me informacionin bazë, p.sh. ku banojnë, a njohin persona të tjerë ose çfarë gjërash kanë, si dhe t'u përgjigjet edhe vetë pyetjeve të tilla).

A2 – Niveli bazë (personi mund të kuptojë fjali dhe shprehje të thjeshta, të cilat lidhen me tema me kuptim të drejtpërdrejtë (p.sh. informacione rreth personit dhe familjes, blerjeve, punës apo ambientit përreth). Mund të merret vesh në situata rutinë, ku bëhet fjalë për shkëmbimin e thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë të informacioneve lidhur me gjëra të njohura dhe të përditshme. Mund të përshkruajë me fjali të thjeshta prejardhjen dhe arsimin e vet, mjedisin rrethues dhe gjëra në lidhje të drejtpërdrejtë me nevoja të çastit.

B - Përdoruesi i pavarur:

B1 - Niveli i pragut (i ndërmjetëm) (personi mund të kuptojë idetë kryesore të një ligjërimi, nëse përdoret gjuha standarde dhe nëse bëhet fjalë për gjëra të njohura nga puna, shkolla, koha e lirë, etj. Mund të përballojë shumicën e situatave gjuhësore me të cilat haset gjatë udhëtimeve në vendet ku flitet gjuha e mësuar. Mund të shprehet në mënyrë të thjeshtë dhe brenda kontekstit rreth temave të njohura dhe fushave personale të interesit).

B2 - Niveli i mesëm i lartë (personi mund të kuptojë përmbajtjen e teksteve komplekse lidhur me tema konkrete dhe abstrakte. Mund të merret vesh spontanisht dhe rrjedhshëm në një bisedë normale me vendas e cila zhvillohet mirë dhe pa ndonjë sforcim të madh mes palëve. Mund të shprehet lidhur me një spektër të gjerë temash në mënyrë të qartë dhe të detajuar, të mbajë një qëndrim për një çështje aktuale).

C - Përdorues i aftë:

C1 - Niveli i aftësisë profesionale (i avancuar), (personi mund të kuptojë një spektër të gjerë tekstesh të sofistikuarra e të gjata dhe të përcjellë domethënie të nënkuptuara. Mund të shprehet në mënyrë spontane dhe të rrjedhshme, shpeshherë pa pasur nevojën për të kërkuar gjatë fjalët e duhura. Mund të përdorë në mënyrë të efektshme dhe elokumente gjuhën në jetën shoqërore dhe atë profesionale, apo në shkollë ose universitet. Mund të shprehet qartë, në mënyrë të strukturuar dhe të rrjedhshme lidhur me çështje të ndërlikuara dhe të vërë në përdorim në mënyrë të përshtatshme mjete të shumëllojshme gjuhësore për ligjërimi të ndryshme).

C2 - Niveli i aftësisë (zotërim i gjuhës), (personi mund kuptojë praktikisht pa asnjë vështirësi çdo gjë që lexon apo dëgjon. Mund të përmbledhë informacione nga burime të ndryshme me shkrim apo me gojë dhe të riprodhojë prej tyre arsyetime dhe sqarime në mënyrë koherente. Mund të

shprehet spontanisht, rrjedhshëm dhe qartë dhe të shfaqë qartazi në çështje të ndërlikuara nuanca të imta kuptimore).

Kurrikula dhe provimet harmonizohen me parimet e kompetencës komunikuese dhe ndërkulturore sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencës për Gjuhët (KPERGj/CEFR), duke u mbështetur në këto shtylla kryesore:

- a. përdorimin funksional dhe kuptimplotë të gjuhës në kontekste reale dhe autentike;
- b. integrimin e pandashëm të gjuhës me kulturën dhe realitetin sociokulturor shqiptar;
- c. zhvillimin e aftësisë për të vepruar në mënyrë të përshtatshme dhe efektive në situata gjuhësore dhe ndërkulturore të ndryshme.

Neni 5

Skema e vlerësimit/ parime të përgjithshme

- a. Skema e vlerësimit duhet të pasqyrojë qartë progresionin cilësor të kompetencave gjuhësore, duke balancuar pikëzimin ndërmjet komponentëve dhe aftësive, si dhe duke respektuar parimet e vlerësimit formativ dhe përmbledhës.

Vlerësimi bazohet në:

- b. katër aftësitë bazë gjuhësore: dëgjim, të folur, lexim dhe shkrim;
- c. përdorimin funksional të gjuhës në situata komunikative të simuluar ose reale
- d. integrimin e elementeve kulturore dhe ndërkulturore në detyrat e vlerësimit;
- e. kriteret cilësore të saktësisë, rrjedhshmërisë, përshtatshmërisë pragmatike dhe koherencës diskursive.

Neni 6

Skema e vlerësimit për çdo nivel duhet të përfshijë:

1. kriteret të qarta dhe të matshme për secilën aftësi;
2. përshkrues performancash (deskriptorë) në përputhje me CEFR;
3. ndarje të balancuar të pikëve midis prodhimit dhe receptimit gjuhësor;
4. vlerësim të vazhdueshëm gjatë kursit dhe vlerësim përfundimtar certifikues.

Neni 7

Skemë vlerësimi shembull për gjuhën shqipe si gjuhë e huaj (A1–B2)

Skema e vlerësimit mbështetet në:

1. katër aftësitë bazë gjuhësore: dëgjim, lexim, të folur, shkrim;
2. ndarje të balancuar midis aftësive receptive (dëgjim + lexim) dhe aftësive prodhuese (të folur + shkrim);
3. kriteret të qarta, të matshme dhe të verifikueshme;

4. përshkrues performance në përputhje me deskriptorët e CEFR;
5. kombinim të vlerësimit të vazhdueshëm (formativ) dhe vlerësimit përfundimtar (certifikues).

Neni 8

A. Struktura e përgjithshme e pikëzimit

Komponenti i vlerësimit	Përqindja
Vlerësim i vazhdueshëm gjatë kursit	40%
Provim përfundimtar certifikues	60%
Totali	100%

B. Ndarja e pikëve sipas aftësive gjuhësore¹

Aftësia gjuhësore	Lloji	Përqindja
Dëgjim	Receptive	25%
Lexim	Receptive	25%
Të folur	Prodhim	25%
Shkrim	Prodhim	25%
Totali		100%

C. Skema e vlerësimit të vazhdueshëm (40%)

Aftësia	Forma e vlerësimit	Përqindja
Dëgjim	Ushtrime kuptimi, detyra autentike	10%
Lexim	Tekste funksionale / narrative / argumentuese (sipas nivelit)	10%
Të folur	Dialogë, role-play, prezantime të shkurtra	10%
Shkrim	Detyra me shkrim (email, përshkrim, narracion, argument)	10%
Totali		40%

C.1 Vlerësimi i vazhdueshëm synon:

- monitorimin e progresit individual;
- dhënien e feedback-ut formativ;
- zhvillimin gradual të kompetencës komunikuese dhe ndërkulturore.

C.2 Skema e provimit përfundimtar (60%)

¹ Kjo ndarje siguron ekuilibër midis receptimit dhe prodhimit gjuhësor (50% – 50%).

Aftësia	Forma e provimit	Përqindja
Dëgjim	Kuptim i tekstit audio autentik / të përshtatur	15%
Lexim	Kuptim i tekstit të shkruar	15%
Të folur	Provim oral (dialog + monolog i drejtuar)	15%
Shkrim	Detyrë me shkrim sipas nivelit	15%
Totali		60%

Prag kalueshmërie (shembull)

1. Kalueshmëria minimale: **60% e totalit**.
2. Asnjë aftësi nuk duhet të jetë nën **50%**, për të garantuar zhvillim të balancuar të kompetencës komunikuese.

Funksioni certifikues i skemës

Skema e vlerësimit:

1. garanton transparencë dhe objektivitet;
2. siguron krahasueshmëri ndërkombëtare sipas CEFR;
3. mbështet certifikimin e kompetencës gjuhësore dhe ndërkulturore për secilin nivel.

Niveli	Lloji i ligjërimit dominues	Fokus vlerësimi
A1	Funksional, situativ	Kuptim bazë, korrektësi minimale
A2	Përshkrues, personal	Koherencë elementare
B1	Narrativ, shpjegues	Organizim dhe qartësi
B2	Argumentues, analitik	Saktësi, stil dhe përshtatshmëri

Neni 9

Kriteret cilësore të vlerësimit (C1–C2)

A. Për të folur dhe shkrim:

1. saktësi dhe pasuri leksikore;
2. koherencë dhe kohezion i avancuar;
3. fleksibilitet pragmatik dhe stilistik;
4. përshtatshmëri ndërkulturore.

B. Për dëgjim dhe lexim:

1. kuptim global dhe analitik;

2. interpretim kritik;
3. dallim i nënkuptimeve dhe qëndrimeve etnokulturore

C. Prag kalueshmërie (shembull)

1. Kalueshmëria minimale: **65%**
2. Asnjë aftësi nën **55%**, për të garantuar profil të plotë kompetence.

C/1. Funksioni certifikues

Skema e vlerësimit për C1–C2:

1. siguron krahasueshmëri të plotë me standardet evropiane;
2. certifikon kompetencë të lartë gjuhësore, diskursive dhe kulturore;
3. përgatit nxënësin për përdorim akademik, profesional dhe publik të gjuhës shqipe;

C/2. Standardet e planit mësimor

1. Harmonizim i plotë me kuadrin ndërkombëtar të njohur (CEFR/KPERGj).
2. Përcaktim i rezultateve të qarta dhe të verifikueshme të të nxënit për çdo nivel.
3. Integrim sistematik i katër aftësive bazë gjuhësore në procesin mësimor dhe vlerësues.
4. Përfshirje e elementeve kulturore të gjuhës shqipe si pjesë organike e përmbajtjes.

Neni 10

Mjedisi i të nxënit

1. Klasat duhet të jenë të pajisura me teknologjinë e nevojshme (projektor, sistem audio, akses në internet).
2. Për kurset online duhet të përdoret një platformë digjitale e sigurt, funksionale dhe e lehtë për përdorim, që mundëson ndërveprim dhe vlerësim të vazhdueshëm.

Neni 11

A. Madhësia e grupit mësimor dhe kohëzgjatja

1. Numri i rekomanduar i nxënësve në klasë: minimumi 6 nxënës.
2. Kohëzgjatja minimale e kursit: 75 orë mësimore për çdo nivel, në përputhje me objektivat dhe rezultatet e të nxënit.

1. Modeli i parë

Modeli më i rekomanduar për mbi 18 vjeç

5 orë mësimore në javë

75 orë ÷ 5 orë/javë = 15 javë

Kohëzgjatja: rreth 3–4 muaj

- ✓ Ritëm optimal për të rritur
- ✓ Mundëson përvetësim të qëndrueshëm dhe praktik
- ✓ I përshtatshëm për kurse gjuhe, formime profesionale, certifikime

1.1. Kursi për pjesëmarrës mbi moshën 18 vjeç zhvillohet me një ngarkesë prej pesë (5) orësh mësimore në javë, duke përfunduar 75 orët mësimore për çdo nivel brenda 15 javësh.

2. Modeli i dytë

Alternativë fleksibël

3- 2 orë mësimore në javë

- ✓ E përshtatshme për pjesëmarrës që punojnë.
- ✓ Ruhët vazhdimësia pa ngarkesë të tepruar.

4.1 Për pjesëmarrës mbi moshën 18 vjeç, kursi për çdo nivel **ka/mund të këtë** një kohëzgjatje minimale prej 75 orësh mësimore, të organizuara në mënyrë javore sipas një ritmi intensiv ose gjysmë-intensiv, në përputhje me objektivat e të nxënësve dhe nevojat e pjesëmarrësve.

Neni 12

Subjektet e rregullores

Institucioni i Arsimit të Lartë

Institucioni, përmes Fakultetit të Edukimit dhe departamenteve përkatëse, është përgjegjës për organizimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e kursit të gjuhës shqipe për të huajt, për sigurimin e infrastrukturës, burimeve mësimore dhe standardeve institucionale.

Stafi akademik / Pedagogët

Pedagogët janë përgjegjës për zhvillimin e mësimi, përdorimin e metodave aktive, vlerësimin formativ dhe certifikues, si dhe për zhvillimin e kompetencave gjuhësore, kulturore dhe ndërkulturore të pjesëmarrësve.

Studentët / Pjesëmarrësit

Të huajt që ndjekin kursin janë subjekt i rregullores dhe kanë përgjegjësi për ndjekjen aktive të mësimi, pjesëmarrjen në aktivitete praktike, përmbushjen e detyrave dhe testeve, si dhe respektimin e rregullave dhe afateve të përcaktuara.

Administrata e Fakultetit

Administrata menaxhon regjistrimin, dokumentacionin, platformën digjitale dhe mbështet zbatimin administrativ të kursit.

Autoritetet mbikëqyrëse

Senati Akademik, Dekanati dhe inspektorët e Arsimit të Lartë mbikëqyrin zbatimin e rregullores,

sigurojnë respektimin e ligjit dhe standardeve institucionale, dhe miratojnë ndryshimet e nevojshme.

Neni 13

Regjistrimi

Kursi zhvillohet sipas kalendarit të publikuar në faqen web të Fakultetit të Edukimit

Çdo person mund të regjistrohet për të kryer kursin me dokumentat përkatëse në dy mënyra, duke u paraqitur në zyrën përkatëse në mjediset e Fakultetit të Edukimit ose nëpërmjet adresës elektronike: -----

- Dokumentet e nevojshme për t'u regjistruar janë:

1. Formulari i Regjistrimit.
2. Kopje e Pasaportës.
3. Dy Fotografitë (formati pasaporte).
4. Vërtetim i Statusit të Qëndrimit në Shqipëri.
5. Vërtetim i Arsimit të Mëparshëm (opsional).
6. Fotokopje të Sigurimit Shëndetësor (nëse kërkohet).
7. Vërtetim i Pagesës së Tarifës së Regjistrimit.
8. Testi i Vendosijes në Nivel.
9. Deklarata e Pranimi të Rregullores.
10. Kontakti i Urgjencës.

a) Mandati i pagesës së tarifës

Shënim: Në rast ndryshimi në mjetin e identifikimit, kandidati paraqitet paraprakisht me mjetin e ri të identifikimit dhe certifikatë familjare (në rast ndryshimi të mbiemrit) ose vërtetim të institucionit përkatës (në rast dëmtimi të mjetit identifikues).

Neni 14

Materialet mësimore

1. Përdorimi i teksteve, fletoreve të punës dhe burimeve digjitale të miratuara institucionalisht.
2. Materialet plotësuese duhet të garantojnë saktësi gjuhësore dhe kulturore, si dhe përshtatshmëri për moshën dhe profilin e nxënësve.

Neni 15

Sigurimi i cilësisë dhe vlerësimi institucional

1. Kryerja e një vlerësimi të brendshëm vjetor të kursit.
2. Vlerësimet e kursit nga nxënësit janë të detyrueshme dhe dokumentohen.

3. Hartimi i planeve për përmirësim të vazhdueshëm, bazuar në feedback-un e nxënësve dhe në rezultatet e vlerësimit.

Neni 16

Standardet etike dhe profesionale

1. Respekt i plotë për diversitetin kulturor dhe gjuhësor.
2. Tolerancë zero ndaj çdo forme diskriminimi.
3. Mbrojtja e të dhënave personale dhe garantimi i konfidencialitetit të informacionit të nxënësve.

Neni 17.

Vërtetimi kurs

- Kandidati mund të tërheqë vërtetimin e provimit të gjuhës 20 ditë pas ditës së provimit.
- Është pa afat;
- Lëshohet në gjuhën përkatëse të provimit;
- Lëshohet vetëm njëherë;
- Mund të tërhiqet në çdo moment vërtetimi i rezultatit, nëse kërkohet një i tillë.

Neni 18.

Dispozita kalimtare (Rishikimi dhe përmirësimi i rregullores)

Kjo rregullore synon të mbështesë një proces të vazhdueshëm përmirësimi të cilësisë dhe funksionimit institucional. Për këtë arsye, ajo i nënshtrohet rishikimit periodik, me qëllim përshtatjen me standardet bashkëkohore, legjislacionin në fuqi dhe praktikën më të mira profesionale. Çdo rishikim realizohet në mënyrë transparente dhe në frymën e bashkëpunimit ndër-institucional.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.